

Qerim LITA

Autonomia politike-territoriale e shqiptarëve në Maqedoni dhe njësitë e para ushtarake

Situata politike në RS të Maqedonisë deri në shpalljen e autonomisë

Rënia e regjimit komunist, te shqiptarët, ngjashëm sikurse edhe te një pjesë e popujve të ish-Federatës komuniste Jugosllave: kroatët, sllovenët dhe boshnjakët, u përjetua si një “çlirim kombëtar”. Në zgjedhjet e para të cilat në RS të Maqedonisë u mbajtën gjatë muajve nëntor-dhjetor 1990, shqiptarët, të cilët përbënin 1/3 e popullsisë u rreshtuan në dy partitë e atëhershme politike: Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) dhe Partia Demokratike Popullore (PDP), të cilat arritën të fitojnë 23 ulëse në Parlament (17 PPD, 1 PDP dhe 5 koalicioni PPD-PDP)¹. Me konstituimin e Parlamentit të parë pluralist e më pas edhe me formimin e të ashtuquajturës qeveri të “ekspertëve”, çështjet jo që nuk ndryshuan në të mirë të shqiptarëve (të cilët thuajse për 10 vite me radhë (1981-1991) qenë skajshmërisht të diskriminuar si në pikëpamjen nacionale, ku me amendamentin kushtetues 56 të vitit 1989 u shpallën pakicë nacionale, po ashtu edhe në atë arsimore, kulturore, ekonomike etj.), por të njëjtat morën një kahe skajshmërisht antishqiptare, të cilat nxiteshin e mbështeteshin nga drejtuesit e atëhershëm politikë e ekzekutivë maqedonas. Në këto rrethana, gjatë

¹ Zeqirja Rexhepi, *Partia Demokratike Shqiptare - lindja zhvillimi dhe veprimtaria*, Tetovë, 2004, f. 27-28.

pranverës së vitit 1991, në disa vendbanime shqiptare u organizuan tubime, në të cilat u shtruan një sërë kërkesash, drejtuar Kuvendit të RS të Maqedonisë si dhe qeverisë së saj, disa prej të cilave po i paraqesim në vazhdim: a) sa më parë të hapen shkollat e arsimimit të mesëm duke filluar nga viti i ardhshëm shkollor 1991/92, të cilat shkolla qenë mbyllur para disa viteve nga mbeturinat e njëmendësisë e burokratike të sistemin monist, të cilët edhe sot e kësaj dite janë në pushtet; b) hapja e fakulteteve me mësim në gjuhën shqipe në dy universitetet ekzistuese në RS të Maqedonisë; c) të merret në përgjegjësi Savo Klimovskit nga fakti se ka kryer shkelje flagrante ndaj arsimit shqiptar, si ideolog i mbylljes së shkollave shqipe të garantuara me ligjet dhe Kushtetutën në fuqi të RSFJ-së; ç) të lirohen të gjithë të burgosurit për shkak delikteve politike, të dënuar e të cilët dënimin e vuajnë si bastion e të burgosurve në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi; d) RS e Maqedonisë të jetë shtet sovran i të gjitha kombeve të cilët jetojnë në të e njëherit edhe i kombit shqiptar si sovran i atij shteti; dh) në ato komuna ku jetojnë shqiptarët, gjuha shqipe të trajtohet në mënyrë të barabartë sikurse edhe gjuha maqedonase përkatësisht në këto komuna të dy gjuhët të përdoren si shtetërore pa majorizimin e njërës apo tjetrës; e) RTV i Shkupit, përkatësisht Televizioni i Maqedonisë një kanal të programit ta ketë në gjuhën shqipe; f) në Kuvendin e RS të Maqedonisë për çështje me rëndësi siç janë: të drejtat e kombeve (arsimi, kultura, simbolet, flamuri, gjuha, toponimet, emërtimi i fëmijëve të porsalindur sipas dëshirës së prindërve të tyre etj.), të

zgjidhet me konsensus e jo me mbivotim e majorizim, në të kundërtën nuk do të pranojmë asnjë akt të cilin do ta sjell Kuvendi... etj.²

Kërkesat e shtruara në mënyrë publike nga shqiptarët, jo që nuk u përfillën, por madje udhëheqja politike e Maqedonisë, gjatë asaj periudhe kohore bëri përpjekje maksimale, të maqedonizohen të gjitha institucionet e atëhershme shtetërore, veçmas ato informative e kulturore si për shembull RTV i Shkupit u emërtua në RTV maqedonase, Filarmonia e Maqedonisë në Filarmonia maqedonase, Opera dhe Baleti i Maqedonisë në Opera dhe Baleti maqedonas etj. Madje disa udhëheqës të lartë të atëhershëm shtetëror të RSM-së, shkuan deri atje sa që për shqiptarët, shpikën termin tepër ofendues “maqedonas me prejardhje shqiptare”.

Se në cilat përmasa kishte shkuar shovinizmi maqedonas i asaj kohe, më së miri mund ta shohim në dokumentin me titull: “Libri i petitionit”, i hartuar, më 26 shkurt të vitit 1991, nga pesë bashkësitë lokale të fshatrave të komunës së Gostivarit: Gallatë, Zuboc, Pozharan, Tumçevisht dhe Vrapçisht. Ashtu siç u tha më lart, gjithçka konsiderohej si maqedonase, duke filluar nga toka, uji, ajri, qielli, dielli hënë, yjet etj., që “rezikohen” nga siç thuhej “përvetësimi i popullit jomaqedonas”, përkatësisht nga “pakica shqiptare”, që sipas tyre përbën rastin e vetëm në botë të kenë dy vende të tyre amë³. Në pjesën e dytë të të ashtuquajturit “Libri i petitionit”, në pika të shkurta përshkruhet “arsyshmëria” përkatësisht “qëllimi” i hartimit të atij dokumenti, ku siç do të shohim në vazhdim, në stilin

² Државен архивна Република Македонија (në vazhdim ДАРМ), 1. 159, Пов. бр. 41-1439/91, Кërkesë e banorëve të Livadhisë së Strugës drejtuar Kuvendit të RS të Maqedonisë, më 18 mars 1991.

³ ДАРМ. 1. 159, ПовБр. 41-5741/91, Петициона Книга (Libri i petitionit), Gostivar, 26 shkurt 1991.

allamillosheviqiane, do të kërkohet marrja e masave të rrepta si nga ana e maqedonasve po ashtu edhe nga vet shteti, për siç thuhej ndërprerjen e politikës “agresive” të shqiptarëve, që në kohë të fundit “po manifestohet gjithnjë e më shpesh në republikë”. Këto masa, sipas tyre duhej të ndaheshin në dy pjesë: urgjente dhe afatgjate, përkatësisht, sistematike. Si masa urgjente parashikoheshin moskonstituimi i kuvendeve komunale në pjesën perëndimore të Maqedonisë, për shkak dominimit të deputetëve shqiptarë, përkatësisht të dy partive të atëhershme shqiptare PPD dhe PDP, deri në shpalljen e zgjedhjeve të reja parlamentare dhe e dyta, shqiptarëve të mos u jepet “as çfarë funksioni” përkatësisht “resori” në pushtetin ekzekutiv republikan. Ndërkohë, të vazhdohej me masa tjera, sistematike, afatgjate, përmes së cilave shqiptarët me Kushtetutë të shpallëshin “pakiçë nacionale”, të pezullohej veprimtaria politike e Partisë për Prosperitet Demokratik dhe Partisë Demokratike Popullore, të mos lejohej përdorimi i flamurit shqiptar, të dëboheshin nga vatrat e tyre, të gjithë ata shqiptarë, të cilët na paskan “zbritur nga qielli” me qëllim të “uzurpimit” të “hapësirës nacionale e territoriale maqedonase”, si dhe të gjithë ata, veprimtaria e të cilëve na qenka “nacionaliste” dhe “problematike”. Përveç kësaj, ata kërkonin që Qeveria e RSM-së, të parasheh arritjen e një marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, për shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje për në shtetin shqiptar “ngjashëm si ajo e viteve pesëdhjeta”, që Tito e arriti me diplomatin e atëhershëm turk FuatKypryli, me ç’rast brenda gjashtë viteve qenë dëbuar me dhunë rreth 150 000 shqiptarë. Për këta albanofobë e shovinistë të tërbuar maqedonas, të gjitha ato masa, kishin karakter “mbrojtës” dhe të njëjtat ishin të “domosdoshme”, të “pashmangshme”, “urgjente”, dhe të “arsyeshme” historikisht, për arsye siç thuhej në pjesën e fundit të

dokumentit “këta mysafirë të paftuar nga bota islame”, nuk kanë “dëshmuar dhe nuk do të dëshmojnë asnjëherë për një jetesë të përbashkët me krishterët”⁴.

Në rrethana, kur të drejtat e shqiptarëve sa vinin e ngushtoheshin, njëra ndër dy partitë e atëhershme shqiptare PDP, doli me një deklaratë politike e cila, më 19 qershor të vitit 1991, u botua në gazetën “Nova Makedonija”. Në pikën dy (2) të saj thuhej: “*PDP është përcaktuar që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t’i pranohet statusi i kombit (janë mbi 3 milionë) edhe atë si shprehje e lirisë dhe të drejtës për përcaktim të lirë nacional, për vetëvendosje dhe me të drejtë të shkëputjes nga robëria totalitare e asimiluese pansllaviste*”⁵. Një qëndrim i tillë i PDP-së, thuhej në vazhdim të deklaratës, vjen si rrjedhojë e refuzimit të kërkesave të pareshtura të shqiptarëve nga udhëheqja e atëhershme maqedonase, e cila “në vend të progresit e zgjodhi regresin”, dhe si rrjedhojë janë bërë dhe po bëhen shumë reduktime e ndalime për shkollim në gjuhën shqipe, “janë miratuar ligje diskriminuese në fushën e shkollimit, u mbyllën shumë shkolla të mesme në gjuhën shqipe, na urdhëruan të mësojmë në “paralelet e përziera”, administratën pedagogjike ta udhëheqim në gjuhë të huaj, sollën vendime për shkollim të mesëm të imponuar vetëm në gjuhën maqedonase, kërkesat gjithëshqiptare për mësim në gjuhën shqipe injorohen nga “shteti demokratik”, pasiviteti shtetëror, që i përket shkollimit në gjuhën shqipe, paraqet një politikë aktive të denacionalizimit dhe asimilimit të kombit shqiptar...etj.”⁶. Deklarata

⁴ Po aty.

⁵ ДАРМ, 1. 159. (Fondi i pasistemuar), Политичка декларација на Собраниетона Народна демократска партија.

⁶ Po aty.

politike e PDP-së, nxiti qarqet e atëhershme shoviniste maqedonase, të involvuara brenda të ashtuquajturës “qeveri të ekspertëve” (në të cilën pa dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve, merrnin pjesë edhe tre shqiptarë), të ndërmarrin masa ndëshkuese kundër popullsisë shqiptare në përgjithësi, e të aktivistëve të kësaj partie në veçanti. Ministria për Informim përmes një komunikate të lëshuar më 27 qershor, Deklaratën e PDP-së, e kualifikoi si një “pamflet” që çon, siç thuhet “kah destabilizimi i Republikës, kah cenimi i marrëdhënieve ndër nacionale...”, krejt kjo “me qëllim të arritjes së funksionit të shkëputjes së pjesëve nga Maqedonia dhe krijimin e një fiksioni për Shqipëri të Madhe”⁷.

Ndërkohë, edhe Partia për Prosperitet Demokratik, më datë 29 korrik 1991, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë i dorëzoi “Deklaratën për statusin e barabartë të shqiptarëve në Maqedoni”. Sipas saj bartës të sovranitetit duhej të ishin të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, ndërsa gjuhë nacionale të shpallëshin maqedonishtja, shqipja dhe turqishtja. Më tej thuhej se, Republika e Maqedonisë duhet të ndërtoj mekanizma kushtetuese përmes së cilave do të garantohet barazia nacionale, pranë së cilave për të gjitha çështjet të cilat u përkasin marrëdhënieve ndërnacionale duhet të vendoset me konsensus. Në pikën nëntë të deklaratës bëhej me dije se: “Shqiptarët në Republikën e Maqedonisë kanë të drejtë të vendosin për fatin e tyre dhe në këtë kontekst ta bartin pjesën e tyre të përgjegjësisë për fatin e Republikës”⁸. Ngjashëm sikurse e para, edhe

⁷ *Po aty*, Соопштение на Министерсво за Информации на Владатана Република Македонија, Shkup, 27 qershor 1991.

⁸ *ДАРМ. Ф.* 159 (fondi i pasisteluar), Декларација за рамноправен статусна Албанцитево Македонија, Пов. бр. 41-3280/1, Shkup, 29 korrik 1991.

kjo Deklaratë u hodh poshtë nga Qeveria e RSM-së, me arsyetimin se “statusi i kolektiviteteve nacionale, pakicave nacionale dhe etnike dhe pjesëtarëve të kombeve tjera” do të definohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë⁹.

Themelimi i Kuvendit të autonomisë dhe organizimi i Referendumit

Si kundërpërgjigje ndaj mohimit të vazhdueshëm të kërkesave për barazi nacionale, dy partitë politike shqiptare, vendosën të bojkotojnë Referendumin për shpalljen e pavarësisë, i cili u mbajt më 8 shtator 1991, pastaj deputetët shqiptarë nuk e votuan Kushtetutën për shkak se me të shqiptarët u shpallën pakicë nacionale, ndërsa paraprakisht qe bojkotuar edhe regjistrimi i popullsisë, i cili u dashtë të mbahet në muajin maj të atij viti. Ndërkohë, më 27 dhjetor të vitit 1991, me nismën e grupit parlamentar shqiptar dhe me përfaqësues, këshilltarë nga kuvendet komunale të 17 komunave të banuara me shqiptarë, në Gostivar në zyrën e Partisë për Prosperitet Demokratik u themelua Kuvendi për shpalljen e Autonomisë Politiko-Territoriale të Shqiptarëve të Maqedonisë (APTSHM-së). Neni 2 i vendimit përcaktonte numrin dhe përbërjen e delegatëve: “Kuvendi përbëhet prej 51 delegatëve. Atë e përbëjnë një grup i deputetëve të Parlamentit të Maqedonisë dhe nga tre këshilltarë të kuvendeve komunale të: Shkupit, Kumanovës, Tetovës, Gostivarit, Strugës, Dibrës, Kërçovës, Ohrit, Resnjës, Manastirit, Krushevës, Makedonski Brodit, Prilepit dhe

⁹ *Po aty.*

të TitoVelesit”¹⁰, ndërsa neni 3 përcaktonte strukturën udhëheqëse të Kuvendit si dhe kompetencat e tij, ku thuhej tekstualisht: “Kuvendi për realizimin e referendumit zgjedh: kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin. Sjell:

- Statut të përkohshëm,
- Rregullore për punën e Kuvendit;
- Emëron kryetar dhe anëtarë të Komisionit Qendror për realizimin e referendumit;
- Emëron trupa ndihmëse për realizimin e referendumit;
- Bën mbikëqyrjen për mirëvajtjen e realizimit të referendumit;
- Kryen punë të tjera që janë në kompetencë të këtij Kuvendi¹¹.

Gjithashtu, në mbledhje u vendos që “më datë 11 dhe 12 janar të vitit 1992 të mbahet Referendum në 17 komuna të Maqedonisë të banuara me shqiptarë”. Në deklaratën e dalë nga kjo mbledhje thuhej: “*Shpresat se me proceset e reja demokratike populli shqiptar do t’i gëzojë të drejtat e veta legjitime nuk u realizuan nga pushteti maqedonas. Në zgjedhjet e para pluraliste demokratike populli shqiptar përsëri pati presione, nuk arriti t’i zgjedh deputetët dhe këshilltarët sipas numrit të votave; populli shqiptar nuk e pranoi regjistrimin e popullsisë sepse nuk u plotësuan kushtet e nevojshme; gjithashtu nuk doli në referendumin e 8 shtatorit jo pse ishte kundër Maqedonisë dhe sovranitetit të saj, por nga se nuk u realizuan premtimet e udhëheqjes së Maqedonisë për barazi të plotë të*

¹⁰ Arkivi Personal i Kryetarit të Kuvendit të Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni (më tej: KAPTSHM), Informatë për punën e Kuvendit dhe komisioneve, Gostivar, janar 1993.

¹¹ KAPTSHM, Vendim për themelimin e Kuvendit për shpalljen e referendumit për autonomi politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni, Nr. 01/91, 27. 12. 1991, Gostivar.

shqiptarëve me maqedonasit; e njëjta gjë ndodhi edhe me Kushtetutën e Maqedonisë, ku të gjitha tentimet dhe përpjekjet që shqiptarët të jenë subjekt i barabartë në Maqedoni, nuk u përfillën nga pushteti maqedonas dhe kështu edhe me ndarjen e pushtetit në Maqedoni. Duke u gjetur në një situatë të tillë, populli shqiptar, me të drejtë e shprehu vullnetin e vetë politik të patjetërsueshëm për shpalljen e Referendumit për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni”¹².

Më datë 30 dhjetor të vitit 1991, u mbajt mbledhja e dytë e Kuvendit në të cilën Gjyliaz Fejzullahu u zgjodh kryetar i Kuvendit, Liman Kurtishi-nënkryetar dhe Naser Zyberi-sekretar¹³. Në kuadër të Kuvendit të APTSHM-së, u formuan këto komisione: Komisioni Qendror për realizimin e referendumit në përbërje: Neim Selmani-kryetar, Ibish Kadriu-zëvendëskryetar, Shehat Shehu-sekretar, Rasim Dauti-zëvendëssekretar, ndërsa për anëtarë të komisionit u zgjodhën: Xhelil Tahiri, Abdullah Ahmeti, Arben Begu, Kadri Pollozhani, Sermet Sulejmani, Halit Hajdari, Qamil Atalko, Latif Karimani, Vebi Rexhepi, Maliq Dauti, Naser Ziberi, Agim Fazliu, Fergim Demiri, Nevruz Hoxha dhe Faik Rushani. Komisioni për Biseda me kryetarin e Republikës, Kiro Gligorov, në përbërje: Nevzat Halili, Iliaz Halimi, Mithat Emini, Gjyliaz Fejzullahu, Liman Kurtishi, Mersel Bilalli, si dhe tre deputetë të cilët do t'i përcaktoj grupi parlamentar. Komisioni për Hartimin e Tekstit për Ndryshimin e Kushtetutës, në përbërje: Abdyraman Haliti, Zudi Emini, Naser Ziberi, Mithat Emini, Neim Selmani, Muhamed Halili, Ismet Ramadani, Mersel Bilalli dhe Olloman Sulejmani. Komisioni për Përcaktimin e Shtrirjes së

¹² KAPTSHM, Informatë mbi aktivitetet për realizimin e Referendumit, Gostivar, janar 1991.

¹³ Po aty.

Autonomisë: Shukri Rahimi, Masar Kodra, Hamit Aliu, Asllan Selmani dhe Vebi Xhemaili. Komisioni për Shpalljen e Zgjedhjeve: Gjyliaz Fejzullau, Naser Ziberi, Liman Kurtishi, Ibish Kadriu, Sermet Sulejmani, Ferit Sadiku, Xhelil Tahiri dhe Reshat Nexhipi. Komisioni për Aktet e Autonomisë: Neim Selmani, Shehat Shehu, Avdi Murtezani, Musli Halimi, Arif Xheladini dhe Agim Fazliu; Komisioni Qendror për Informim: Ferit Fejzullahu, Nazif Selimi, Abdylnaser Sinani, Sejdali Saliu, Hidajet Elmazi, Qamil Atalko dhe Gajur Ramadani¹⁴, dhe; Komisioni për Çështje Strategjike: Mithat Emini-sekretar i përgjithshëm i PPD-së dhe kryetar i komisionit, ndërsa anëtarë tjerë ishin: kolonel Naxhi Ahmeti, Ismet Shabani-Shkupi, Shinasi Rexhepi, Abdyl Vehap Ismaili, dr. Ilir Luma, Resmi Ejupi, Selam Elmazi, Samet Hyseini, Sejdali Saliu, Sejdin Abazi, Zudi Bilalli, Eugen Cami, Petrit Fetahu, Arif Seferi, Naim Ibrahim, Hysen Haskaj, Ismet Berisha, Muhamet Demiri dhe Fatmir Stavileci¹⁵. Po në këtë mbledhje u vendos që referendumi të mbahet më datë 11 dhe 12 janar të vitit 1992, në vendbanimet që do t'i përcaktoj Kuvendi me vendim të posaçëm. Ndërkohë, Komisioni Qendror për Realizimin e Referendumit, në mbledhjen e mbajtur më 3 janar, solli vendimin për mbajtjen e Referendumit, përmbajtja e të cilit ishte me sa vijon:

Neni 1

Për realizimin e Referendumit për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, qytetarët do të deklarohen në

¹⁴ *Po aty.*

¹⁵ *KAPTSHM*, Vendim për mbajtjen e Referendumit, Gostivar, 03. 01. 1991, Gostivar.

pyetjen: “A jeni për autonomi politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni”.

Qytetarët do të deklarohen në mënyrë që në pyetjen e parashtruar nga alineja 1 e këtij neni me rrethimin e fjalës “PËR” ose “KUNDËR.

Neni 2

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e aprovimit”¹⁶.

Ndërkohë, kryetari i Kuvendit të APTSHM-së, Gjyliaz Fejzullahu, me shkresën Nr. 03-14/91 të datës 6 janar 1991, njoftonte kryetarin e republikës, Kiro Gligorovin për datën e mbajtjes së Referendumit dhe njëherit kërkon, t’i ndërmerr të gjitha masat për zhvillimin normal të Referendumit: “*Ju njoftojmë se Kuvendi për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, në mbledhjen e mbajtur, më 27 dhjetor 1991, duke u nisur nga Deklarata e BE-së në Bukuresht më 17 dhjetor 1991, projekt-dokumentin e Konferencës të Paqes për Jugosllavi dhe Deklaratën e Kuvendit të Maqedonisë, në lidhje me plotësimin e kushteve për pranimin ndërkombëtar të Maqedonisë, solli vendim për shpalljen e Referendumit për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, i cili referendum do të mbahet, më datë 11 dhe 12 janar të vitit 1992, dhe qytetarët shqiptarë e të tjerë do të deklarohen për pyetjen: “A jeni për autonomi politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni”. Prandaj, Ju lusim të ndërmerrni masa përkatëse për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të referendumit*”¹⁷. Menjëherë

¹⁶KAPTSHM, Собрание за политичко –териториална Автономија на албанцитево Македонија, Бр. 03-14/91, 6. 01. 1991, Гостивар.

¹⁷ KAPTSHM, Informatë mbi aktivitetet për realizimin e Referendumit, Gostivar, janar 1991.

pas kësaj shkrese, filloi një fushatë e egër shtetërore kundër Referendumit shqiptar, të cilës fillimisht i paraprinë mjetet e informimit në gjuhën maqedonase: RTV i Maqedonisë, shtypi, radiostacionet lokale e tjerë, që më pas të përfshihet edhe vetë qeveria, në krye me kryetarin e atëhershëm Nikolla Klusev, si dhe të gjitha partitë politike maqedonase, duke i akuzuar shqiptarët në përgjithësi, e udhëheqjen e PPD-së e të PDP-së në veçanti, se me shpalljen e Referendumit, ata dëshirojnë “ta cenojnë integritetin territorial të Maqedonisë”, se me këtë “mund të vijë deri te gjakderdhja”¹⁸ etj. Në anën tjetër, policia maqedonase, më 7 janar 1991, bastisi Shtëpinë Botuese ku qe paraparë të shtypet materiali i Referendumit, duke iu kërcënuar pronarit të shtëpisë “se do të pësoj shumë keq” nëse vazhdon me shtypjen e atij materiali. Në prag të mbajtjes së referendumit, me urdhër të Ministrisë për Punë të Brendshme, policia bastisi shtëpitë e disa aktivistëve për organizimin e Referendumit, një pjesë e të cilëve edhe u privuan nga liria¹⁹.

Mirëpo, as fushata antishqiptare e as represioni policor ndaj aktivistëve të dalluar të çështjes shqiptare, nuk qenë në gjendje ta pengonin vullnetin e popullit shqiptar. Kjo u pa që në mëngjesin e ditës së parë të referendumit (11 janar), ku mijëra shqiptarë dolën në vendvotimet e tyre, për të votuar “PRO” autonomisë shqiptare. Komisioni Qendror për organizimin e Referendumit, i raportonte Kuvendit të APTSHM-së, se në ditën e parë të votimit, në ora 11:30, “filloi aksioni policor, duke marrë kutitë dhe materialet votuese”, për çka, votimi u ndërpre për një kohë të shkurtë. Në vazhdim të raportit, thuhej se në tërë Maqedoninë, ishin hapur 500 vendvotime, ndërsa në

¹⁸ *Po aty.*

¹⁹ *Po aty.*

260 prej tyre kishte intervenuar policia. Në vendvotimet ku nuk pati intervenime nga ana e policisë “rrjedha e votimit është zhvilluar pa asnjë ndërprerje”, ndërsa në vendvotimet ku policia kishte konfiskuar tërë materialin zgjedhor “komisionet sërish janë angazhuar dhe e kanë vazhduar punën në gjysmlegalitet me të vetmin qëllim që t’u mundësojnë qytetarëve të deklarohen”²⁰.

Dy ditë pas përfundimit të referendunit (14 janar), Komisioni Qendror për organizimin e Referendunit, në selinë e Kuvendit të APTSHM-së (Gostivar), organizoi një preskonferencë, me ç’rast u theksua se përkundër përpjekjeve të organeve policore për ta penguar mbajtjen e tij, i njëjti përfundoi me një sukses të jashtëzakonshëm. Nga gjithsej 383 894 votues shqiptarë të regjistruar në 17 komunitat përkatëse, në votim kishin dalë 361 627, prej tyre 361 263 kanë votuar “PRO” Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, 57 “KUNDËR”, dhe 307 fletëvotime të pavlefshme²¹. Gjithnjë sipas të dhënave të Komisionit, krahas 17 komunave të përmendura, referendumi ishte organizuar edhe për qytetarët shqiptarë me punë të përkohshme, në: Kosovë, Slloveni, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë si dhe 15 shtetet e Evropës Perëndimore, SHBA, Kanada dhe Australi. Referendumi u përcoll edhe nga disa gazetarë të agjencive ndërkombëtare si: “Zëri i Amerikës”, “Frans Pressi”, “Elefterotipia”, agjencitë telegrafike të Austrisë, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe të SHBA-së. Referendumin e madhështoi prezenca e një delegacioni të lartë të SHBA-së, në krye me ish-kongresistin dhe lobistin e njohur

²⁰ *Po aty.*

²¹ KAPTSHM, Raport mbi punën e Komisionit Qendror për realizimin e referendunit për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, i mbajtur më datë 11 dhe 12 janar 1992, Gostivar, 14. 01. 1992.

shqiptar, Jozef Diogardi, i shoqëruar nga kryetari i Kongresit të Fondacionit të Lirë, Pol Weriç, gazetari Xhon Fonda, Osman Osmani dhe Mark Lleshi. Ky delegacion drejtpërdrejt u njoftua me pozitën e pavolitshme të shqiptarëve në Maqedoni, ku siç thuhet në informatën e Komisionit Qendror për Informim “vetë ata qenë dëshmitarë në Strugë dhe Kërçovë se si policia i konfiskonte kutitë e votimeve dhe materialet votuese si dhe keqtrajtimin e anëtarëve të Komisionit votues”. Nga po kjo polici, thuhej në vazhdim të informatës “edhe atë vetë disa herë u keqtrajtuuan duke ua kontrolluar valixhet e tyre gjatë udhëtimit prej Gostivari për në Kumanovë”²². Është me rëndësi të theksohet se me rastin e mbajtjes së Referendumit, Kuvendit të APTSHM-së, i arritën shumë telegrame dhe letra përhëndetëse nga disa personalitete të rëndësishme ndërkombëtare, që me këtë rast po e veçojmë letrën e ministrit për Punë të Jashtme të Belgjikës, atë të ministrit për Punë të Jashtme të Irlandës, Lordit Karington, Shoqatës Shqiptaro-Amerikane, Jozef Diogardi etj.²³

Aktiviteti për jetësimin e autonomisë

Suksesi aq i madh që u arrit në Referendum, nxiti udhëheqjen e Kuvendit të APTSHM-së të ndërmer hapa konkret drejt jetësimit të tij. Menjëherë pas përfundimit të Referendumit, Kryesia e Kuvendit, mbajti mbledhje në të cilën u vendos të grumbullohen 150 000 nënshkrime, që ishte parakusht për ngritjen e iniciativës për ndryshimin e Kushtetutës. Për këtë qëllim, dy komisioneve: Komisioni për Hartimin e Tekstit për Ndryshimin e Kushtetutës si dhe Komisioni për

²² *Po aty.*

²³ *Po aty.*

Përcaktimin e Shtrirjes së Autonomisë, iu rekomandua që sa më parë që është e mundur, t'i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre²⁴. Në kuadër të Komisionit të parë u përfshinë edhe një numër i konsiderueshëm i ekspertëve shqiptarë, profesor të njohur të Universitetit të Prishtinës, siç ishin: Esat Stavileci, Gazmend Pula, Zejnullah Gruda, Iliaz Kurteshi etj., me ndihmën e të cilëve së shpejti u përgatit teksti, përkatësisht “Propozimi për ngritjen e iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë”, i cili përbëhej prej tetë (8) pikave: 1. Me preambulën e Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë të shprehet e vërteta historike se popuj konstituivë të Republikës së Maqedonisë janë populli maqedonas dhe shqiptar, të cilët gjatë historisë kanë luftuar bashkërisht për liri nacionale dhe shtet të përbashkët. 2. Republika e Maqedonisë të ndërtohet si shtet modern, social, demokratik i qytetarëve dhe popujve të barabartë dhe sovran me ndërtimin e përmbajtjeve të atilla të Kushtetutës që do të sigurojnë dhe garantojnë: a) Përdorim të barabartë zyrtar të gjuhëve të kombeve dhe nacionaliteteve në të gjitha nivelet; b) Përfshirje proporcionale në organet shtetërore dhe pushtetin lokal; c) Status të barabartë në lëmin e arsimit, shkencës, kulturës dhe veçorive nacionale nëpërmjet garantimit të të drejtave për shkollim në gjuhën amtare në të gjitha nivelet, formimin e institucioneve nacionale për kultivimin e kulturës nacionale, historisë dhe traditave si dhe përdorimit të lirë të simboleve kombëtare. 3) Rendi juridik efikas, si garancë për siguri juridike të qytetarëve dhe kolektiviteteve nacionale me ndarje strikte të pushtetit ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. 4. Organizimi dhe funksionimi i pushtetit të mbështetet në njësitë lokale dhe rezultatet e zgjedhjeve të

²⁴ *KAPTSHM*, Informatë për punën e Kuvendit dhe të komisioneve, Gostivar, janar 1993.

lira dhe demokratike. 5. Krijimi i mekanizmit kushtetuese për mbrojtjen e garancave kushtetuese. Në këtë kuptim Kuvendi i R. së Maqedonisë të jetë dydhomësh: Dhoma e qytetarëve dhe Dhoma e kombeve dhe kolektiviteve nacionale në të cilat konsensusi do të jetë kriteriumi themelor i vendosjes. 6. Status i barabartë në lëmin e informimit nëpërmjet të së drejtës së kombeve dhe kolektiviteve nacionale për informim në gjuhën e tyre amtare. 7. Konstituimi i sistemit ekonomik stabil juridiko-kushtetues, i mbështetur në ekonominë e tregut dhe pronës juridiko-shtetërore me instrumente të ndërtuara për siguri individuale dhe kolektive, ekonomike dhe sociale të qytetarëve dhe kolektiviteve nacionale. 8. Të pranohet dhe garantohet në mënyrë juridiko-kushtetuese e drejta me aktet ndërkombëtare të miratuara, organizimi i autonomive politike të kombeve dhe nacionaliteteve që jetojnë në R. e Maqedonisë me ndërtimin e kaptinës së veçantë në Kushtetutën e Maqedonisë²⁵. Në fund, teksti i përshkruante shkaqet themelore rreth kërkesës për ndryshimin dhe plotësimin të Kushtetutës, disa prej të cilave po i paraqesim në vazhdim: “degradimi i popullit shqiptar në pakicë nacionale; mohimi i subjektivitetit të tij konstituiv të shtetit dhe e drejta e tij për vetëpërcaktim; pabarazia e tij me kombin maqedonas në të gjitha fushat; mohimi i autoktonisë së tij; mosrespektimi i vullnetit politik të shqiptarëve të shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe demokratike; mospërfshirja e tij proporcionale në organet e pushtetit shtetëror... etj.”²⁶.

²⁵ *KAPTSHM*, Propozim për ngritjen e iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë.

²⁶ *Po aty*.

Ndërkohë, edhe Komisioni për përcaktimin e shtrirjes së Autonomisë, hartoi projektin me titull: “Vazhdimësia e elementit shqiptar në Maqedoninë e sotme”. Fillimisht projekti përcaktonte kufijtë, përkatësisht shtrirjen e shqiptarëve, ku thuhej shprehimisht: “Populli shqiptar shtrihet edhe në një hapësirë të gjerë të Maqedonisë së sotme, e cila fillon nga Kumanova me rrethinë, duke kaluar nëpër Shkup, pjesërisht nëpër Veles, Prilep, Krushevë dhe disa vende të tjera të Maqedonisë Lindore, ndërsa në Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër, Prespë, Ohër vazhdon që të banojë duke mbaruar me Manastirin”. Sipas hartuesit të Projektit, shtrirje e popullit shqiptar nga lindja shkon mes lumenjve Treska dhe Vardar, në drejtim të veriut nga Morava Jugore dhe drejtohet nga veriu në Jeni Pazar, përkatësisht, Pazari i Ri dhe del në Tivar. “Popullata shqiptare - theksohej në Projekt - gjithmonë ka qenë shumicë në këto hapësira në krahasim me grupet e tjera etnike të Maqedonisë së sotme, e në veçanti, në raport me popullin maqedonas”. Një rëndësi të veçantë i kushtohet edhe autoktonisë së shqiptarëve, e cila siç vihej në dukje, datonte që nga parahistoria dhe antika kur shqiptarët njiheshin si “pellazgë e ilirë”, ndërsa një kohë gjatë mesjetës së hershme e më vonë, nën emrin “arbëreshë” dhe së fundi si “shqiptarë”. Rrëzimi i sistemit monist, sipas hartuesve të Projektit “ngjalli shpresë të madhe të populli shqiptar në Maqedoni”, se më në fund “do t’i sigurojë të gjitha të drejtat kombëtare”, ngjashëm sikurse edhe maqedonasit, mirëpo edhe kësaj radhe mbeti i degraduar, madje “nuk iu pranua as statusi i cili i qe garantuar në Mbledhjen e KAKÇM-së, të vitit 1944, as me atë të Kushtetutës së vitit 1974, që të jetë element shtetformues”. I gjetur në këtë pozitë, theksohej në fund të dokumentit: “Populli shqiptar, u përcaktua nëpërmjet Referendumit të mbajtur, më datë 11 dhe 12 janar të vitit 1992, me ç’rast 99% të

votuesve u deklaruan për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni”²⁷.

Një dokument tjetër me rëndësi, paraqet letra e kryetarit të Kuvendit të APTSHM-së, Gjyliaz Fejzullahut, dërguar më 14 shkurt të vitit 1992, deri te Komisioni i Arbitrazhit, të cilën në vazhdim po e japim në formë të shkurtuar: “...*Me interes të veçantë lexuam pjesën e Raportit për njohjen e Republikës së Maqedonisë nga ana e Bashkësisë Evropiane dhe shteteve anëtare të sajë. Me keqardhje konstatojmë se në raportin e Komisionit të Arbitrazhit nuk janë marrë në konsiderim faktet e pakontestueshme natyrore, historike dhe aktuale të jetës dhe të veprimit të afro 40% të popullatës së tërësishme në këtë Republikë, e cila i përket kombit shqiptar, e që me datë 11 dhe 12 janar 1992 nëpërmjet Referendumit u deklarua për autonomi politiko-territoriale në trojet e veta etnike. Në raportin e Komisionit të Arbitrazhit të Bashkësisë Evropiane për Jugosllavinë u nënçmuan dhe u injoruan këto fakte të pamohueshme:*

- *se shqiptarët në Maqedoni jetojnë në trojet e veta etnike si popull autokton;*

- *se shqiptarët në Maqedoni i karakterizon kompaktësia e tyre etnike dhe territoriale;*

- *se shqiptarët në Maqedoni paraqesin një etnikum të veçantë nacional gjuhësor dhe kulturor;*

- *se shqiptarët në trojet e veta etnike janë popull shumicë në regjionin përkatës;*

- *se statusi sovran dhe shtetformues i popullatës shqiptare i garantuar me nenin 1 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë nga viti 1974, me Kushtetutën aktuale është degraduar në*

²⁷KAPTSHM , Vazhdimësia e elementit shqiptar në Maqedoninë e sotme.

nivelin e pakicës nacionale dhe kështu populli shqiptar barazohet me pakicat etnike, simbolikisht të përfaqësuara në strukturën nacionale të Maqedonisë - turqit, romët, vllehtë etj.;

- se mbi të drejtat njerëzore kolektive nacionale të shqiptarëve dhe nacionaliteteve tjera, nuk ekziston mekanizëm mbrojtës-konsensus;

- se të drejtat dhe liritë njerëzore individuale dhe kolektive të Maqedonisë sipas Kushtetutës në fuqi, janë të palimitueshme, kurse ato të tjerëve në mënyrë taksative limitohen ose përcaktohen me ligje të veçanta.

Të gjitha këto fakte u nënçmuan dhe u injoruan me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të aprovuar, më 17 nëntor të vitit 1991.

Me këtë rast shprehim bindjen tonë se shqiptarët në Maqedoni nuk janë kundër pavarësisë së Maqedonisë dhe njohjes së sajë nga ana e Bashkësisë Evropiane dhe e shteteve anëtare të saj, me kusht që edhe atyre t'u njihet autonomia politiko-territoriale si hap kah zgjidhja e drejtë dhe e barabartë e çështjes shqiptare, në pajtim me Aktin Final të Helsinkit 1975 dhe Kartës së Parisit për një Evropë të re (1990), dokumente këto që e njohin të drejtën e vetëvendosjes për secilin popull...”²⁸.

Një ditë më vonë, përkatësisht, më 15 shkurt 1992, Gjyliaz Fejzullahu përmes një letre, në emër të Kuvendit të APTSHM-së i shprehte mirënjohje kongresistit amerikan, Tom Lantosh, “për angazhimin e tij dhe paraqitjen e Propozim-Rezolutës në Kongresin Amerikan” lidhur me kërkesën për autonominë politike-territoriale të

²⁸ KAPTSHM, KAPTSHM, Letër e kryetarit të Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, dërguar Komisionit të Arbitrazhit, më 12 shkurt 1992 .

shqiptarëve në Maqedoni²⁹. Me qëllim të aktualizimit dhe jetësimit të autonomisë, udhëheqja e APTSHM-së, gjatë muajve shkurt-mars 1992, zhvilloi një aktivitet të gjerë si në këndvështrimin politik poashtu edhe në atë informativ. Në suazat e këtij aktiviteti duhet veçuar botimin e një numri të konsiderueshme të informatave, vështrimeve, intervistave dhe shkrimeve të tjera në shtypin ditor e periodik si brenda hapësirës shqiptare poashtu edhe në botën e jashtme. Përveç kësaj, Kuvendi, më 12 mars, përmes një letre njoftonte dymbëdhjetëshen evropiane, Lordin Karington, një numër të ambasadave të shteteve evropiane, SHBA-në, Turqinë dhe Shqipërinë “për pozitën e shqiptarëve në Maqedoni dhe kërkesën për autonomi politike-territoriale”³⁰.

Në kuadër të aktivitetit për jetësimin e autonomisë shqiptare, nuk duhet harruar qëndrimin disaditor në Gostivar të delegacionit të SHBA-së, në përbërje: Josef Diogardi, Porkwist Grover, Stefan Wiliam, Osman Osmani dhe Xheksi Sadiku. Gjatë qëndrimit treditor (11-13 mars 1992), delegacioni zhvilloi bisedime të ndara me kryetarin e Forumin Demokratik për të drejtat e njeriut, Milaim Fejziun, me kryetarin e Kuvendit të APTSHM-së, Gjyliaz Fejzullahun, me deputetët shqiptarë: Neim Selmani, Zudi Bilalli dhe Ferit Sadiku, si dhe me kryetarët e dy partive politike shqiptare, Nevzat Halilin dhe Iliaz Halimin. Ardhja e serishme e Diogardit, sipas burimeve të kohës “lidhej ngushtë me internacionalizimin e autonomisë shqiptare”³¹.

²⁹ KAPTSHM, Unitet Statesof America, Congressional Record - Proceeding sanddebates of the 102ndCongress, First Sesion - In Supportof Automy for Ethnic Albanians in Macedonia, Hon. Tom Lantosof California IN THE HOUSE REPRESENTATIVES, February 3, 1991.

³⁰ KAPTSHM, Informatë për punën e Kuvendit, po aty.

³¹ Po aty.

Krijimi i njësive ushtarake

Një aktivitet të dendur të asaj kohe pati edhe “Komisioni për çështje strategjike, i cili ndryshe njihej edhe si “Komisioni për Organizimin e Njësive Ushtarake”, me të cilin siç u tha më lartë, udhëhiqte sekretari i përgjithshëm i PPD-së, Mithat Emini. Ky Komision së shpejti rekrutoi një numër të konsiderueshëm të ushtarëve, të cilët u dërguan në Shqipëri për stërvitje, ku në mesin e tyre duhet përmendur: Nuri Bexhetin, Halil Palloshin, Sami Golajn, Halil Latifin, Sedat Osmanin, Fatmir Fejzullahun, Orhan Ibrahimin, Naser Jakupin, Adem Maksutin, Samet Ibrahimin e shumë të tjerë. Stërvitja e tyre kryhej nën komandën e Adem Jasharit, i cili në Shqipëri kishte shkuar gjatë muajit nëntor të vitit 1991³².

Aktiviteti i dendur i këtij komisioni përcillej në hap nga shërbimi i atëhershëm sekret UDB-së. Ministria e Punëve të Brendshme, më 24 shkurt 1992, njoftonte Qeverinë, për disa aktivitete të cilat kohët të fundit ishin vërejtur në mesin e popullsisë shqiptare, për të cilat kjo Ministri dyshonte se bëhet fjalë për krijimin e njësive paraushtarake: *“Sipas disa të dhënave të pakonfirmuara në mesin e popullsisë shqiptare këtyre ditëve po kryhen evidenca për persona me qëllim të formimit të njësive ushtarake të cilët si qëllim primar do ta kenë mbrojtjen e popullsisë shqiptare dhe të organizojnë rezistencë mbarëkombëtare të popullsisë në territorin e autonomisë pas pranimit ndërkombëtar të saj dhe fillimin e funksionimit në rast se organet e pushtetit të R. së Maqedonisë do të përpiqen të ndërmarrin çfarëdolloj*

³² Intervistë që autori i këtij punimi e zhvilloi, më 25 janar 2018 në Shkup, me njërin ndër themeluesit e njësive ushtarake në Maqedoni, Ismet Shabanin.

*masash represive ndaj popullsisë shqiptare në territorin e saj*³³. Po i njëjti burim, në mars të vitit 1992 përmes një informate konfidenciale, njoftonte Qeverinë e Maqedonisë, për një organizim ushtarak të shqiptarëve në Maqedoni, i cili veçmas kishte ardhur në shprehje “pas realizimit të referendumit për autonomi politike e kulturore të shqiptarëve në R. Maqedonisë”. Në të veç tjerash thuhej: “Sipas njohurive të verifikuara nga ne e udhëheqjes së PPD-së dhe anëtarëve ekstremë të kësaj partie, është krijuar ushtria kombëtare shqiptare, me shtabin e përgjithshëm (komisioni strategjik i PPD-së për mbrojtje) dhe “shtabet ushtarake” nëpër qytete ku jetojnë qytetarët e nacionalitetit shqiptar³⁴. Në kuadër të shtabeve janë krijuar edhe “komisione” të veçanta të cilët punojnë në përgatitjen e planeve konkrete për aktivitetin e të njëjtëve. Udhëhiqet evidenca ndaj obliguesve ushtarak - persona të cilët pranojnë të radhiten në ushtrinë kombëtare të shqiptarëve, me qëllim që të mund të mobilizohen me kohë”. Gjithnjë sipas këtij burimi, Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, e udhëhiqte Mithat Emini, ndërsa Naxhi Ahmeti, ishte zgjedhur koordinator i përgjithshëm për organizimin dhe për formën e vendosjes së ushtrisë dhe drejtuesit e shtabeve ushtarake të qyteteve të pjesës Perëndimore të R. Maqedonisë edhe atë për Shkup: Ismet Shabani, Hysen Haskaj, Ismet Berisha, Muhamet Demiri dhe Fatmir Stavileci; për Tetovë: Shinasi Rexhepi, Abdylvehap Ismaili dhe Ilir Luma; për Gostivar: Resmi Ejupi, Selam Elmazi, Samet Huseini, Sejдали Saliu dhe Zudi Bilalli; për Kërçovë: Sejdi Abazi; për Dibër: Eugen Cami dhe Petrit Fetahu; për Kumanovë: Arif Seferi dhe Naim Ibrahim, ndërsa për aktivitetet në botën e jashtme, koordinator të përgjithshëm ishin

³³ ДАРМ, 1. 885, Пов. стр. пов. бр. 172, Скопје, 24. 02. 1992 год.

³⁴ *Po aty*, Пов. стр.. Пов. бр. 317, Скопје, март 1992 год.

zgjedhur, në: Gjermani, Vehap Memishi dhe në Zvicër, Shaip Bilalli dhe Xhemail Rexhepi³⁵.

Një ngjarje tjetër me peshë historike për shqiptarët në përgjithësi, e për shqiptarët e Shkupit në veçanti, paraqet ardhja e Adem Jasharit dhe grupit të tij në këtë qytet të lashtë shqiptar. Në intervistën e kryer me Ismet Shabanin-Shkupi, kjo ngjarje ka ndodh në dhjetor të vitit 1992 kur forcat ushtarake policore serbe sulmuan kullat e Jasharajve. Sipas tij, Adem Jashari së bashku me Fadil Kodrën, Sami Lushtakun, Sahit Jasharin, Iliaz Kodrën, Jakup Nurën, nën përcjelljen e Milazim dhe Bajram Çiçavicën, vendosen në Shkup në shtëpinë e Ismet Shabanit. Gjatë kohës përderisa Adem Jashari dhe grupi i tij qëndroi tek ai, krejt rastësisht ka ardhur Mujë Krasniqi, i cili me ta ka zhvilluar një bisedë të shkurtë dhe më pas është nda nga ata. Për çështje sigurie, Adem Jashari me grupin e tij ishte dashtë të qëndroj plotë 11 ditë te shtëpia e Ismetit, që më pas nën përcjelljen e tij (Ismet Shabanit), kanë udhëtuar për në Dibër të Madhe dhe nga atje ilegalisht e kanë kaluar kufirin për t'u vendosur në shtetin shqiptar. Është me rëndësi të theksohet se edhe kthimi i Adem Jasharit për në Kosovë është bërë përmes Dibrës së Madhe, të cilin organizim gjithashtu e ka udhëheq Ismet Shabani³⁶.

Shuarja e idesë së autonomisë

Aktiviteti i bujshëm i strukturave udhëheqëse të Kuvendit të APTSHM-së, dhe të dy partive politike shqiptare, përcillej në hap nga qarqet e atëhershme qeveritare. Ministria për Punë të Brendshme,

³⁵*Po aty.*

³⁶ Intervistë me Ismet Shabanin.

përmes një shkrese konfidenciale, njoftonte Qeverinë e R. Maqedonisë se dy partitë shqiptare, PPD dhe PDP, kohëve të fundit po mbajnë kontakte të shumta me krerët e “alternativës kosovare” (LDK-së), nga të cilët marrin instruksione konkrete për aktivitetet e mëtutjeshme “për institucionalizimin dhe zyrtarizmin e mëtutjeshëm ndërkombëtar të autonomisë shqiptare”³⁷. Me qëllim të kryerjes sa më profesionale dhe sa më parë të punëve rreth zyrtarizmit përfundimtar të “autonomisë shqiptare në Maqedoni - thuhej në informatë - si dhe përgatitjen e materialit në lidhje me kërkesën për ndryshimin e Kushtetutës, më datë 15 shkurt 1992, në Gostivar, nga Kosova kanë arritur Esat Stavileci, Zejnullah Gruda dhe dy profesorë tjerë nga Prishtina, të cilët në Gostivar duhet të realizojnë kontakt me Gjyliaz Fejzullahun, Neim Selmanin, Mithat Eminin, Nevzat Halilin dhe Iliaz Halimin”. Ky grup i profesorëve, siç bënte me dije informata “duhet ta përgatis edhe Projekt-Kushtetutën e Autonomisë”, dhe se pas hartimit përfundimtar të këtyre dokumenteve “për ta duhet të njoftohet Bashkësia Evropiane me qëllim të kryerjes së presionit për mospranimin e shtetësisë së R. Maqedonisë”. Në fund të informatës, jepej vlerësimi i MPB-së, ku thuhej tekstualisht: *“Sipas vlerësimit tonë, aktivitetet e tilla të separatistëve dhe shovinistëve shqiptarë për “institucionalizimin” dhe “zyrtarizmin ndërkombëtar” e të ashtuquajturës “autonomi shqiptare” janë në kuadër të aktiviteteve të përgjithshme të pjesëtarëve ekstremistë të partive nacionale shqiptare për ndryshimin e kufijve të R. Maqedonisë, si pjesë e strategjisë globale për krijimin e shtetit të madh shqiptar në Ballkan, që përbën sulm të drejtpërdrejtë ndaj rregullimit kushtetues të R. Maqedonisë”*³⁸.

³⁷ ДАРМ. 1. 885, Информација, стр. пов. бр. 367, Скопје, април 1992 год.

³⁸ KAPTSHM, Informatë për punën e Kuvendit dhe të komisioneve.

Menjëherë pas kësaj informate, qarqet shoviniste maqedonase, të instaluar brenda qeverisë së atëhershme, nëpërmjet mjeteve të informimit në gjuhën maqedonase e filluan një fushatë të gjerë, e cila për qëllim pati përçarjen e strukturës politike shqiptare. Kësaj fushate iu bashkëngjiti edhe Kiro Gligorovi, i cili së shpejti për këshilltar të tij personal, emëroi disa funksionarë të lartë të regjimit të mëparshëm me prejardhje shqiptare, të cilët dolën me tezën se “kërkesa për autonomi”, nënkupton se “shqiptarët me vetëdëshirë e pranojnë statusin e pakicës nacionale”. Prandaj, ajo si e tillë “duhet të hidhet poshtë”, dhe njëherit të shkohet me kërkesën “elementit konstituiv”, përkatësisht “shqiptarët, krahas maqedonasve të jenë element shtetformues të Maqedonisë”. Njëri prej tyre, madje shkoi aq larg, sa që të merr guximin që para anëtarëve të Kuvendit Qendror të PPD-së, punimet e të cilit u zhvilluan në pranverë të vitit 1992 në Shkup: “Interesi strategjik i shqiptarëve është që Maqedonia të shkëputet nga Serbia, prandaj ne duhet ta pranojmë pavarësinë e këtij shteti e të insistojmë që shqiptarët në këtë shtet të pavarur, së bashku me maqedonasit të jenë element konstituiv”.³⁹ Pikërisht, kjo deklaratë, përkundër faktit se doli nga goja e një njeriu, i cili në atë moment nuk përfaqësonte asnjë forum të asaj partie, apo të ndonjë shoqate joqeveritare shqiptare, krijoi huti brenda strukturës udhëheqëse të PPD-së. Nga procesverbali i mbledhjes së zgjeruar të Kryesisë Qendrore të kësaj partie, punimet e së cilës u zhvilluan, më 24 prill të vitit 1992 në Tetovë, informohemi se pjesa më e madhe e deputetëve dhe të ministrave shqiptarë u distancuan nga shpallja e autonomisë, dhe në fjalimet e tyre kërkuan të hedhet poshtë kjo ide, dhe të shkohet, siç do të shprehen “në një opsion më të pranueshëm” për palën maqedonase, e që sipas tyre është

³⁹*Po aty.*

“kërkesa për barazi të plotë të shqiptarëve me maqedonasit”. Kundër këtij opsiioni doli shumica dërmuese e anëtarëve të Kryesisë, si dhe një pjesë e deputetëve, të cilët theksuan se “kërkesa për shpalljen e Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedonisë, përbën një obligim kombëtar i shprehur në mënyrë plebishitare në Referendumin e 11 dhe 12 janarit”⁴⁰.

Rrjedhimisht, kjo ide e shpikur nga qarqet qeveritare maqedonase, e cila si qëllim parësor, pati përçarjen brenda strukturës udhëheqëse shqiptare, e cila asaj kohe ishte e bashkuar si asnjëherë më parë, u reflektua edhe brenda anëtarëve të Kuvendit të APTSHM-së. Në Informatën e zgjeruar të Komisionit për Informim të APSHM-së, në lidhje me punën dhe aktivitetin njëvjeçar të Kuvendit dhe të komisioneve të tij, vihej në dukje se “ngadalësimi i aktivitetit të Kuvendit”, filloi që në mbledhjen e zgjeruar të datës 30 prill 1992, në të cilën përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të dy partive politike shqiptare, në të cilën është debatuar për projekt-dokumentet: “Propozimi për ngritjen e iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë” dhe “Vazhdimësia e elementit shqiptar në Maqedoninë e sotme”⁴¹, për të cilët u bë fjalë më lartë. Në mbledhje për herë të parë në sipërfaqe dolën mendime të ndara për atë se a duhet shkuar në këtë moment “në jetësimin e autonomisë ose edhe më tutje të vazhdohet me kërkesën për shtetformues” dhe për rrjedhojë, në mbledhjen e Kuvendit u vendos të zhvillohen konsultime me ekspertët⁴². Një ditë më pas, një delegacion i Kuvendit i udhëhequr nga kryetari Gjyliaz Fejzullahu i

⁴⁰ ДАРМ. 1. 885.

⁴¹ КАРТШМ, Informatë për punën e Kuvendit dhe të komisioneve.

⁴² По аты.

shoqëruar edhe nga përfaqësues të lartë të dy partive të atëhershme politike shqiptare, udhëtuan për në Prishtinë me ç’rast zhvilluan një bisedë me ekspertët e njohur shqiptarë të fushës juridike, siç ishin: Esat Stavileci, Gazmend Pula, Zejnullah Gruada e të tjerë, të cilët shprehën bindjen e tyre se, nuk ka kohë për të pritur, porse duhet shkuar urgjentisht në “jetësimin e autonomisë”. Ata, veç tjerash delegacionit të APTSHM-së, i sugjeruan që “të përgatitet një kërkesë” e cila do të bazohej në tekstin e projekt-dokumentit për jetësimin e autonomisë, të cilën deputetët shqiptarë duhej t’ia dorëzonin kryetarit Kiro Gligorov⁴³.

Nga të dhënat e burimeve autentike të APSHM-së, të cilat me përkushtim janë ruajtur nga kryetari i saj, i ndjeri Gjyliaz Fejzullahu, provojnë se sugjerimet e ekspertëve shqiptarë nga Kosova, fare nuk umorën parasysh nga kryesitë e dy partive politike shqiptare, të cilat, në ndërkohë, hartuankërkesën, drejtuar Parlamentit, ku kërkohet që “shqiptarëve t’u njihet statusi i shtetformësisë”. E njëjta edhe pse u paralajmërua në një konferencë për shtyp, nuk iu dorëzua Parlamentit, ndërsa kërkesa e rekomanduar nga ekspertët, nuk u përgatit fare.⁴⁴ Pikërisht nga ky moment filloi tatëpjeta e jetësimit të Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, për arsye se partitëpolitike shqiptare, në radhë të parë Partia për Prosperitet Demokratik, si parti e cila përfaqësonte mbi 90% të elektoratit shqiptar, fare nuk u angazhua në krijimin e kushteve për vazhdimin e punës së Kuvendit, nuk themeloi fondin financiar të tij, dhe për rrjedhojë ideja për jetësimin e APTSHM-së u shua fare. E gjithë kjo krijoi pakënaqësi dhe huti tek shqiptarët. Shumë degë të PPD-së si brenda ashtu edhe në botën perëndimore, përmes reagimeve dhe protestave të shkruara,

⁴³ *Po aty.*

⁴⁴ *Po aty.*

kërkonin sqarim se “përse ngecin aktivitetet rreth jetësimit të autonomisë”. Pyetje të kësaj natyre, thuhet në një dokument të hartuar nga Kuvendi i APTSHM-së “shtrohen si në kohë ashtu edhe në hapësirë”, si nga qytetarët ashtu edhe nga asociacione apo subjekte të ndryshme, për çka “me plotë përgjegjësi - thuhej në fund të dokumentit - konsiderojmë se përgjigje duhet të japin dy partitë politike PPD-ja dhe PDP-ja, me grupin parlamentar në krye”.⁴⁵ Heqja dorë nga jetësimi i autonomisë, u shfrytëzua maksimalisht nga pushteti i atëhershëm maqedonas, i cili së shpejti morri masa represive ndaj popullsisë shqiptare në përgjithësi, e te një pjesë e strukturës udhëheqëse shqiptare në veçanti, siç ishin rastet në Bit Pazar, Ladorisht, Afera e Armëve etj.⁴⁶

Punimin, kushtuar Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedonisë dhe njërive të para ushtarake në këto treva etnike shqiptare, e pash të arsyeshme ta përfundoj duke iu referuar një pjese të intervistës së kryetarit historik të Kuvendit të APSHM-së, intelektualit dhe atdhetarit të devotshëm, të ndjerit Gjyliaz Fejzullahut, dhënë gazetarit të gazetës “Bujku”-Prishtinë, Ismail Arslanit, me rastin e njëvjeterit të Referendumit për themelimin e autonomisë shqiptare në këto treva etnike: *“Besoj se për këtë nuk duhet menduar shumë. Dihet mirëfilli se cilat janë përparësitë e statusit shtetformues. Shtrohet pyetja: cilat janë argumentet që kjo të realizohet?! Pushteti maqedonas nuk është aq naiv që më shumë reagon kur përmendet referendumi e autonomia, kurse më pak kur fjala për statusin e shtetformuesit. Sa i përket autonomisë politike-territoriale, mund t’i*

⁴⁵ *Po aty.*

⁴⁶ ДАРМ, 1. 158, (fondi i pasisteluar), Стенографски белешки од дванаесето топродолжениена Педесет и шестатаседницана Собраниетона Република Македонија, одржанна 5 мај 1993 година.

potençoj qëndrimet e ekspertëve. Elementi shtetformues - po, mirëpo pa mekanizëm mbrojtës (konsensus) nuk do të ishte asgjë, kurse element shtetformues pa territor të caktuar, përkatësisht autonomi, nuk mund të ketë”⁴⁷.

⁴⁷ KAPTSHM, Intervistë e Gjyliaz Fejzullahut dhënë Ismail Arslanit, asaj kohe gazetar i gazetës “Bujku” të Prishtinës, me rastin e njëvjektorit të mbajtjes së Referendumit për APTSH-në.

